

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN GRYK ÇAJË, KUKËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në komunën Gryk Çajë, aktualisht njësia Administrative Bashkisë Kukës, me objekt:“Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.07.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 129, datë 24.09.2015.

Bazuar në nenet 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 573/7, datë 24.09.2015, i ka rekomanduar z. Bashkim Shehu, Kryetar i Bashkisë Kukës, në të cilën përfshihet njësia Administrative Gryk Çajë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi

Nuk ka gjetur zbatim plotësisht ligji nr. 10296, datë 08.07.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi nuk kishin dalë aktet administrative për caktimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, nuk ishin hartuar dhe miratuar sistemet e menaxhimit të informacionit. Nuk janë ndjekur dhe nuk ka raportime të titullari i njësisë publike për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, për të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejton .

Rekomandimi:Bashkia Kukës ,në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Gryk-Çajë, të ngrej e miratoj një sistem për komunikimin dhe përcjelljen e informacionit ndërmjet sektorëve dhe eprorëve si pjesë e llogaridhënies, bashkëpunimit dhe e kontrollit të brendshëm, duke vendosur një sistem efikas të kontrollit të brendshëm.

2. Gjetje nga auditimi: Në kërkesat për kualifikim të paraqitura në formatin elektronik, nga Njësia e Prokurimit, në disa raste, nuk është kërkuar, që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të paraqesin:

-Vërtetim për shlyerjen e taksave e tarifave vendore në njësitë vendore ku kryejnë veprimtarinë.

-Numrin e nevojshëm të punonjësve, të dokumentuar nga organet tatimore me listëpagesat e sigurimeve shoqërore.

Rekomandimi:Njësia e Prokurimit në çdo rast në dokumentet e tenderit duhet të kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të plotësojnë kërkesat për kualifikim sipas kërkesave ligjore.

3. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni kualifikues i paraqitur në rrugë elektronike nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tendera, në disa raste ata janë kualifikuar edhe pse kanë pasur mangësi në dokumentacionin kualifikues.

Rekomandimi

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejt kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit duke u mbështetur në plotësimin e tyre me dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organe kompetente.

4. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e prokurimit me vlera të vogla janë konstatuar mangësi në drejtim të moszbatimit të UMF nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, i hartuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, nenit 43 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe neneve 15 e 22 të ligjit 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin Financiar e kontrollin” e konkretisht:

Mungonte kërkesa e argumentuar për kryerjen e shpenzimit brenda limitit që përcakton ligji të blerjet me vlera të vogla;

Nuk ishin përcaktuar sipas rastit specifikimet teknike të shërbimit, apo mallit që do të blihej; Nuk evidentohet ngritja e grupit për testimin e tregut dhe as çmimet e marra për bazë në llogaritjen e fondit limit.

Rekomandimi: Bashkia Kukës (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Gryk-Çajë) në çdo rast të prokurimit të fondeve publike me procedurën e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël, të argumentoj domosdoshmërinë e kryerjes së shpenzimeve, të hartoj sipas rasti preventiv dhe specifikime teknike të mallit, punës, apo shërbimeve dhe të pasqyrohet testimi i tregut, apo të dhënave statistikore, për përcaktimin e çmimit dhe argumentimin e fondit limit.

5.Gjetje nga auditimi: Nuk është hartuar Inventar të pronave të paluajtshme shtetërore në pronësi apo përdorim të ndodhura nën territorin administrativ të njësisë, për rrjedhojë nuk ka VKM “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në territorin administrativ të Komunës Gryk-Çajë, të Qarkut Kukës”. Komuna nuk administron të dhëna lidhur me sipërfaqet e trojeve të objekteve social kulturore apo ekonomike, objekteve, rrugëve vendore, veprave rrugore, veprave kulluese, trojeve të lira, tokës bujqësore të pa ndarë, Vreshtave, Pemishteve apo dhe pasurive të tjera, të ndodhura nën juridiksionin territorial të komunës, veprime **në kundërshtim me ligjin nr. 8743**, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

Rekomandimi: Bashkia Kukës (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Gryk-Çajë) të marrë masat dhe të kryej të gjitha procedurat për evidentimin, pasqyrimin dhe regjistrimin të aseteve nën territorin administrativ të ish-komunës, si dhe të paraqes për miratim në organet përkatëse, në zbatim të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

6. Gjetje nga auditimi: Me VKM nr. 759, datë 28.5.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Çajë, të Qarkut të Kukës”, i ka kaluar në pronësi Komunës Gryk-Çajë 3181 ha pyje prodhues, kullotë, bimësi pyjore, inproduktive dhe djerrin. Komuna nuk ka zbatuar pikën 3 VKM nr. 759, datë 28.5.2008, e cila ngarkon “... dhe Komunën Çajë për zbatimin e këtij vendimi”, pasi nuk është aplikuar për regjistrimin e këtyre pasurive në regjistrat e ZVRPP në zbatim të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, veprime në kundërshtim edhe me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, nenet 9, 10, 13 dhe UMF nr. 30 datë **27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30.**

Rekomandimi: Bashkia Kukës (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Gryk-Çajë) të marrë masat dhe të kryej të gjitha procedurat për aplikimin dhe regjistrimin në ZVRPP Kukës të VKM nr. 759, datë 28.5.2008, në zbatim të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

7. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha asetet e Komunës, është vepruar në kundërshti me Kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim.

Në kundërshtim me nenin 31/d, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

Rekomandimi: Bashkia Kukës (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Gryk-Çajë) të marrë masat dhe të kryej të gjitha procedurat për mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim, si dhe regjistri i veçantë për secilën nga

pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit, kontrata e qirasë, afati i vlefshmërisë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik, etj.

8. Gjetje nga auditimi: Nuk është filluar apo ndërmarrë asnjë nisëm për ngritjen e grupit të përbashkët të punës për hartimin e procesverbalit të marrjes në dorëzim të pronave, akti i cili mbahet nga përfaqësuesit e DSHP Kukës dhe ata të Komunës, si dhe nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin e plotë, azhurnimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim pasqyrimin e gjendjes reale, ndryshimin e zërave kadastral aty ku situata faktike në terren nuk përkon me gjendjen në regjistrin e inventarit të pasurisë

Rekomandimi: Bashkia Kukës (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Gryk-Çajë), të kërkoj zyrtarisht bashkëpunim me DSHP Kukës, me qëllim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve dhe konkretisht: hartimin e procesverbalit të marrjes në dorëzim të pronave; përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin e plotë, azhurnimin e gjendjes faktike në terren duke bërë pasqyrimin e gjendjes reale si dhe ndryshimin e zërave kadastral, për rastet kur konstatohet se situata faktike në terren nuk përkon me gjendjen në regjistrin e inventarit të VKM nr. 759, datë 28.5.2008.

9. Gjetje nga auditimi: Nuk është vepruar për dhënien me qira me procedurën e ankandit, të sipërfaqes pyjore të përfituar sipas VKM nr. 759, datë 28.5.2008, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, kreu IV, neni 19, ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin kullosor”, i ndryshuar, neni 18, VKM nr. 22, datë 9.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pika 6 dhe UMMPAU nr. 1 datë 2.7.2012 “Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik”, pika 7 dhe pika 10, pasi e gjithë sipërfaqja u është lënë në përdorim banorëve pa kundërshtpërblim, shfuqizuar nga Udhëzimi nr. 4, datë 22.04.2013.

Nuk është mbajtur parasysh se përdorimi i pyjeve dhe kullotave komunale konsiston në administrimin dhe përdorimin e tyre mbi bazën e ligjit nr. 9385, datë 04.5.2005, i ndryshuar, ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, i ndryshuar, VKM nr. 22, datë 09.01.2008, dhe Udhëzimit nr. 1 datë 02.7.2012, ndryshuar me Udhëzimin nr. 4, datë 22.04.2013.

Rekomandimi: Bashkia Kukës (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Gryk-Çajë) të krijoj strukturën e administrimit të fondit pyjor dhe kullosore në pronësi të NJQV, sipas VKM nr. 759, datë 28.5.2008.

Me hartimin e kësaj strukture, nga NJQV të hartohet plani operacional me të gjithë aktivitetet që mund të zhvillohen në fondin pyjor dhe kullosore komunal si:

- Planin e shfrytëzimeve për furnizimin e banorëve me dru zjarri;
- Planin e grumbullimit të bimëve mjekësore me anë të procedurave të ankandit (grumbullimi i të ardhurave);
- Grumbullimin e të ardhurave nga kullotat etj
- Mundësinë e dhënies në përdorim me procedurë ankandi të shesheve dhe guroreve.
- Hartimin e kadastrës pyjore komunale dhe raportimin për çdo vit për ndryshimet e ndodhura në fondin pyjor e kullosor në DSHP;
- Pasqyrimin e prerjeve të paligjshme dhe rënies së zjarreve nëse ka pasur;
- Ndarjen e përdoruesve për plotësimin e nevojave të veta me dru zjarri dhe hartimin e kontratave për dhënien në përdorim të sipërfaqeve pyjore

10. Gjetje nga auditimi: Nga moskryerja e procedurave të trajtuara në gjetjen dhe rekomandimin 10, si: moszbatimi; mosplanifikimi dhe grumbullimi i të ardhurave; mos hartimi i projekteve dhe zbatimi i tyre për ndërhyrje silvikulturale; etj. ka sjellë si pasojë mos shfrytëzimin në mënyrë të qëndrueshme të pyjeve dhe kullotave komunal Gryk-Çajë, mos krijimin e të ardhurave nga përdorimi i tyre, si dhe lejimin e përdorimit të resurseve komunale në mënyrë të kundraligjshme.

Nga të dhënat e DSHP Kukës rezulton se Volumi drusor i shfrytëzueshëm sipas planit të menaxhimit është 18384 pjesëtuar me 10 vite që është afati i planit të menaxhimit = 1838 m³

në vit dru zjarri =3051 mst dru zjarri pjesëtuar me 10 mst/familje në vit = 305 familje që mund të siguronin drutë e zjarrit në pyjet e veta (komunës) me anë të ndërhyrjes silvikulturale të parashikuar në planin e menaxhimit komunal.

Bimët mjekësore, kryesisht Boronica, shtrihet nën një sipërfaqe prej 370 ha, ku sipërfaqja e shfrytëzueshme është 70% ose 259 ha me boronicë dhe me kapacitet prodhues 0.5 kv/ha ose 130 kv/ha.

Sipërfaqja totale e kullotave në pronësi të komunës është 924 ha dhe kapaciteti kullosor është 3 dele ose të imta/ha, ose me kapacitet maksimal prej 2772 krerë.

Duke përllogaritur efektin financiar të munguar, për qëllime kullosore, sipas tarifave të miratuara me VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje”, të ardhurat e përfituara nga njësia e qeverisjes vendore, e për rrjedhojë të ardhura të munguar për një vit janë:

Për sipërfaqen kullosore; 2772 krerë të imta x 100 lekë/krerë janë 277,200 lekë në vit për 3 (tre) vite janë 831,600 lekë, shumë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Gryk-Çajë.

Për sipërfaqen për Kositje; 103.5 ha x 1 lekë/m² janë 1,035.000 lekë në vit për 3 (tre) vite janë **3,105,000 lekë, shumë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Gryk-Çajë (Trajtuar në faqet 48-56 të Raportit Përfundimtar të auditimit).**

Rekomandimi: Bashkia Kukës (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Gryk-Çajë) me qëllim eliminimin e përdorimit në mënyrë të paligjshme të resurseve dhe krijimit të të ardhurave ekonomike, të evidentohen të gjithë përdoruesit e paligjshëm të pasurive të kaluara në pronësi me VKM nr. 759, datë 28.5.2008, si dhe tu bëhet me dije subjekteve fizike e juridike që duan ti shfrytëzojnë këto resurse, hapësirat ligjore që lejojnë shfrytëzimin e ligjshëm të tyre, sipas VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje”.

11. Gjetje nga auditimi: Nga mos lidhja e kontratave për qëllime përdorimi të bimëve mjekësore, duke u lejuar përdorimi i paligjshëm i 259 ha me Boronicë dhe me kapacitet prodhues 130 kv/ha ose maksimalisht i 33670 kv, ka sjellë për pasojë moszbatimin e VKM nr. 391, datë 20.06.2006 “Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, lidhja 5, “Tarifat për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta”, Lule të Ndryshme, ku tarifa për Kv është përcaktuar 450 lekë.

Si rezultat i moszbatimit të nenit 25 “Kontrata” të ligjit nr. 10120, datë 23.04.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore, e tanifere natyrore”, i ndryshuar me ligjin 42/2013 dhe VKM nr. 391, datë 20.06.2006 “Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, kanë sjellë të ardhura të munguar për NJQV Komuna Gryk-Çajë ku duke marrë për referencë shfrytëzimin maksimal të resurseve, **të ardhurat e munguara llogariten në vlerën prej 15,151,500 lekë (450 lekë/kv x 33670).**

Rekomandimi: Bashkia Kukës (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Gryk-Çajë) me qëllim eliminimin e përdorimit në mënyrë të paligjshme të resurseve dhe krijimit të të ardhurave ekonomike, të evidentohen të gjithë përdoruesit e paligjshëm të pasurive të kaluara në pronësi me VKM nr. 759, datë 28.5.2008, si dhe tu bëhet me dije subjekteve fizike e juridike që duan ti shfrytëzojnë këto resurse, hapësirat ligjore që lejojnë shfrytëzimin e ligjshëm të tyre, sipas VKM nr. 391, datë 20.06.2006 “Për caktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, si dhe ligjit nr. 10120, datë 23.04.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore, e tanifere natyrore”, i ndryshuar me ligjin 42/2013.

12.Gjetje nga auditimi: Në Llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, për vitet 2012-2013 ndërsa për vitin ushtrimor 2014, kjo llogari shprehet në vlerën 1,169,675 lekë. Me urdhrin e titullarit nr.4, datë 10.12.2013 rezulton se është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve të Komunës Çaj i përbërë nga 5 anëtarë, nga i cili pasi është bërë evidentimi i këtyre

materialeve prej komisionit më 15.04.2014 (4 muaj me vonesë) është mbajtur procesverbali “Për propozimin për daljen jashtë përdorimit të materialeve të dëmtuara në të gjitha shkollat e Komunës Çajë si dhe në zyrat e administratës të kësaj Komune”. Materialet janë asgjësuar në prani të komisionit të inventarizimit dhe jo atij të asgjësimit, pra nuk ka urdhër konkret për ngritjen e komisionit të asgjësimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 96 dhe pika 97.

Rekomandimi: Bashkia Kukës (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Gryk-Çajë) të marrë masa për krijimin e komisionit për asgjësimin e aktiveve në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, pika 96 dhe pika 97.

13.1. Gjetje nga auditimi: Në Llogarinë 32 “Objekte inventari”, janë përfshirë sendet, orenditë dhe materialet e ndryshme në pronësi të subjektit, si dhe materiale të cilat janë me vlerë mbi 10,000 lekë të cilat janë të detajuara sipas shkollave si më poshtë vijon: Shkolla 9 vjeçare Fshat në vlerën totale **78,201 lekë** e përbërë nga sendet kompjuter i vjetër (copë 1) në vlerën 50,450 lekë; printer (copë 1) në vlerën 14,601 lekë; fotokopje (copë 1) në vlerën 13,150 lekë. Në shkollën 9 vjeçare Shkinak PC (kompjuter 1 copë) në vlerën **44,339 lekë**. Shkolla 9 vjeçare Çajë në vlerën totale **28,748 lekë**, shumë e cila përbëhet nga printer (copë 1) në vlerën 16,514 lekë si dhe monitor (copë 1) në vlerën 12,234 lekë. Shkolla 9 vjeçare Buzmadhe në vlerën totale **67,703 lekë**, shumë e cila përbëhet nga kompjuter (copë 1) në vlerën 51,189 lekë si dhe printer (copë 1) në vlerën 16,514 lekë.

Në inventarin e komunës bëjnë pjesë edhe objekte me vlerë më të madhe se 10,000 lekë si më poshtë vijon: Tavinë e madhe 1 copë në vlerën 50,000 lekë; kompjuter në vlerën 61,189 lekë. Pra në total në këtë llogari rezulton shuma totale prej **330,180 lekë** së bashku me tavlinë dhe kompjuterin e komunës; veprime në kundërshtim me nenin 29 Udhëzim nr. 30 Datë 27.12.2011, sipas të cilit: “Kufiri minimal për pragun e vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale është 10000 leke dhe afat përdorimi mbi një vit...” (Trajtuar në faqet 15-20 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

13.2. Rekomandimi: Bashkia Kukës (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Gryk-Çajë) të marrë masa duke kryer rregullimet dhe rakordimet e nevojshme lidhur me Llogarinë 32 “Objekte Inventari”, duke përfshirë në të aktivet materiale afatshkurtra (me afat përdorimi nën një vit dhe me vlerë më të vogël se 10,000 lekë për çdo artikull) në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011.

Brenda muajit Shtator 2015

14.1. Gjetje nga auditimi: Në veprimet e kryera nëpërmjet Bankës, në dy raste janë kryer shpenzime për dru zjarri në vlerën 450,000 lekë si dhe shpenzime kancelarike në vlerën 450,000 lekë duke tejkaluar limitin e lejuar 400,000 lekë, në kundërshtim me pikën 4 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar i cili shprehimisht sqaron se: “Autoriteti kontraktor mund të realizojë disa procedura blerje me vlerë të vogël gjatë vitit kalendarik në varësi të nevojave dhe mundësi të tij, por shuma e këtyre procedurave për të njëjtin mall, shërbim ose grup mallrash nuk duhet të jetë më e madhe se 400.000 (katërqindmijë) lekë në vit” (Trajtuar në faqet 23-37 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Rekomandimi: Bashkia Kukës (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Gryk-Çajë), të marrë masa për të mos tejkaluar limitin e lejuar për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël sipas udhëzimeve përkatëse së bashku me ndryshimet e legjislacionit të prokurimeve të vitit 2015.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, Bashkisë Kukës (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Gryk-Çajë) të nxirren

aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të kërkohet **shpërblimi i dëmit në vlerën 129,500 lekë**, si më poshtë:

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në veprimet e kryera nëpërmjet bankës rezultoi se në 13 raste janë bërë pagesa për dieta kur dokumentacioni rezultonte i pa plotë dhe i pa saktë dhe qëllimi i shërbimit është i paargumentuar, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, pika 3b, pika IV dhe pika V, **veprim i cili i ka shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën totale prej 129,500 lekë**.

Rekomandimi: Bashkia Kukës (në të cilën përfshihet si njësi administrative Komuna Gryk-Çajë) të marrë të gjitha masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **129,500 lekë**, përfituar padrejtësisht dhe në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010, pika 3b, pika IV dhe pika V.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58, germa a, b, c, ç, “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 8, të kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ti kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Kukës, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “**Largim nga puna**” dhe për ata me kontratë, nga masa “**Vërejtje**” deri në “**Ndërprerje të marrëdhënieve të punës**”, për këta punonjës:

1. M.Sh, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës, pasi:

Buxhetet janë miratuar nga Këshilli i Komunës, jashtë afatit ligjor, në kundërshtim me nenin 32 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, ku përcaktohet se: “Brenda muajit Nëntor të vitit buxhetor, ... paraqesin për miratim buxhetet e këshillave të tyre.

Lidhur me rregullaritetin e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës rezultoi se në dy raste nuk ka zbatuar Udhëzimin nr.2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, , pasi është tejkaluar limiti prej 400,000 lekë.

Në veprimet e kryera nëpërmjet bankës rezultoi se në 13 raste janë bërë pagesa për dieta në kundërshtim me VKM nr.997, datë 10.12.2010, pika 3b, pika IV dhe pika V(2), **veprim i cili i ka shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën totale prej 129,500 lekë**.

2. B.D anëtar i KVO

3. H.D anëtar i KVO

4. B.L anëtar i NJP

5. Xh.M. anëtar i NJP

Për shkelje dhe parregullsi të kryera në 2 procedura prokurimi dhe konkretisht:

1- Tenderi me objekt “Rehabilitimi i rrugës Çaj-Fshat-Buzmadhe 11.6 km, në Komunën Gryk-Çajë” u konstatuan këto mangësi:

-Njësia e Prokurimit përbëhet nga 3 persona, nuk është përbërë dhe nuk ka funksionuar me specialist të fushës, pasi nga të cilët 1 inxhinier i kontraktuar jashtë punonjësve të Komunës është pa kontratë pune apo shërbimi, ndërsa 2 anëtarët e tjerë punonjës të Komunës me arsim të mesëm, në kundërshtim me germën “b” të pikës 2 të kreut V të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kjo për mungesë personeli.

Për hapjen e tenderit është caktuar data 31.7.2014 dhe në tender kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë skualifikuar 2 operatorë ekonomikë me mangësi në dokumentacionin kualifikues dhe janë kualifikuar 2 operatorët e tjerë.

Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentacionin kualifikues të paraqitur në formatin elektronik nga operatori ekonomik bashkimi i përkohshëm i shoqërive “**A... sh.p.k. & “F....” sh.p.k.** rezultoi se:

1. Shoqëria “Arifaj” sh.p.k. ka detyrime në shumën 9,691,355 lekë ndaj Administratës Tatimore, e dokumentuar kjo me vërtetimin me nr. 9674. prot, datë 24.6.2014, gjë që tregon mospërbushje të kërkesës së germave “d” e “dh” të nenit 45 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuat.

2. Në kontratën e bashkëpunimit pjesëmarrja në zbatimin e punimeve është përcaktuar në masën 51% për shoqërinë “A...” sh.p.k. dhe 49% për shoqërinë “F...” sh.p.k., pa specifikuar zërat e punimeve që do të realizojë secila shoqëri në bazë të masës së angazhimit.

3. Shoqëri “F...” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokument që të vërtetojë realizimin e punëve të ngjashme me volum të kryer në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkëpunim.

Në këto kushte operatori ekonomik bashkimi i përkohshëm Shoqëria “A....” sh.p.k. & “F...” sh.p.k. duhej të ishte skualifikuar.

6. z. F.D, me detyrë Polic i Komunës, pasi:

Nuk ka plotësuar kërkesat e nenit 5 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”, i ndryshuar dhe nenit 11/2 të Urdhrit nr. 1530, datë 07.04.2003, pasi nuk ka formimin e duhur ligjor, pra rezulton se nuk ka përfunduar studimet e larta në Akademinë Ushtarake, por as formim policor, pasi nuk ka përfunduar Akademinë e Rendit Publik apo Akademinë e Policisë.

Emërimi është bërë në kundërshtim me sa përcaktuar nga neni 5 i ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, pasi nuk është krijuar komision i posaçëm, i kryesuar nga përfaqësuesi i Prefektit dhe përfaqësuesi i komisarariatit të policisë, pra përzgjedhja është bërë pa komision.

Nuk i është lidhur kontratë pune për një periudhë me afat jo më pak se 3 vjeçare, në kundërshtim me kërkesat e Urdhrit nr. 1, datë 17.04.2003 “Për miratimin e rregullores TIP të policisë bashkiake dhe të komunës”, neni 11, pikat 5 dhe 7.

Nuk ka mbajtur asnjë procesverbal apo dokument tjetër për evidentimin e subjekteve pa lejë apo mos pagesën e detyrimeve fiskale.

Nuk ka raste të dhënies së gjobave për zënie të ambienteve publike, për mbrojtjen e mjedisit, për raste të prerjes pa leje të pyjeve etj.

Nuk ka programe të miratuara lidhur me mbrojtjen e ambientit, kontrollin mbi mbjelljen e bimëve narkotike etj., çka tregon për një angazhim të pakët të kësaj strukture në funksion të detyrave ligjore.

Mungojnë planet dy javore të aktivitetit të policisë si dhe planet e shërbimit për çdo rast, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, nenet 15 dhe 35.

Nga Bashkia Kukës, ku bën pjesë Njësia Administrative Gryk Çajë (ish komuna), është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi e zbatimi.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Ryisin Xhaja, Vasillaq Peci, Rezart Golemaj dhe Taulant Dervishaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT